

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: NDERTIM I AMBJETENTEVE SPORTIVE SHKOLLA "TRING SMAJLI " (JETO ME SPORTIN)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45212221-1 - Punime ndërtimi për struktura për terrene sportive,

VLERA E FONDIT LIMIT: 44,476,045 (Dyzet e katër milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyzet e pesë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe si dhe në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022-2023-2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës që prokurohet dhe konkretisht **44,476,045 (Dyzet e kater milion e katerqind e shtatedhjetë e gjashtë mijë e dyzet e pesë) lekë pa tvsh.**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", *"Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën", "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës",* si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar

se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **44,476,045** (Dyzet e kater milion e katerqind e shtatedhjete e gjashte mije e dyzet e pesë) lekë pa tvsh.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare) që është vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2022-2023-2024 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njepasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* (i ndryshuar).

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqenese operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **22,238,022** (Njezet e dy milion e dyqind e tridhjetë e tete mijë e njezet e dy) lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
 - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **88,952,088** (Tetëdhjetë e tete milion e nentëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e tete)leke.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Çertifikaten e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - Faturë tatimore përkatëse të **deklaruar në organet tatimore**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4 në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zoterojnë burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuarën dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”...Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b)

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat **50%** të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi** i vlerës limit të kontratës që prokurohet , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht në vlerat **50%** % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose **dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet** , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,neni 39,pika 8 *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), ., Udhezimi i K.M nr.2 ,datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 ”Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit“ të ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vertetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 pika 5/a dhe b, duhet të paraqesin Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, aktin e kolaudit, Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim për punët e kryera me entet publike, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar , koha e realizimit , dokumentacioni i kolaudit dhe marrjes në dorezim të objektit si dhe vleresimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor,elemente të nevojshme për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi ne toke”

Kategoria NP-2 Niveli A “Ndertime civile dhe industriale”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge autostrada mbikalime”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa ,gazsjellesa,vepra kullimi e vaditje”

Kategoria NP-11 Niveli A “Ndertime per N/Stacione kabinat e transformatoreve...”

Kategoria NP-12 Niveli A “Punime te inxhinierise te mjedisit”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve ...”

Kategoria NS-4 Niveli A “Punime te rifinitures dhe te lidhura me to ...

Kategoria NS-6 Niveli A “Sinjalistike rrugore jondricuese”

Kategoria NS-8 Niveli A “Ndertime p/f me beton te armuar struktura metalike dhe druri”

Kategoria NS-14 Niveli A “Impiante te brendshme elektrike,telefonike radiofoni elektrike”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane" Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<u>Kategoria NP-1</u>	Punime germimi ne toke	Punimet sipas preventivit ,zeri nr,1,3	Niveli A	561,877 leke pa tvsh ok
<u>Kategoria NP-2</u>	Ndertime civile dhe industriale	Punimet sipas preventivit ,zeri nr,19,20,22,42,43,44,60,61, 6263,64,65,66,68,69,70,71, 72,73,74	Niveli A	11,910,896 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-4</u>	Rruge ,autostrada ,mbikalime..	Punimet sipas preventivit, zeri nr 4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,25,26,59	Niveli A	12,434,922le ke pa tvsh
<u>Kategoria NP-7</u>	Ujesjelles,gazsjelles,ve pra kullimi dhe vaditje	Punimet sipas preventivit ,zeri nr,30,34,36,49,76	Niveli A	1,532,673 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-11</u>	Ndertime per N/Stacionet,kabinat e transformatoreve linja te tensionit te larte dhe te mesem per shperndarjen e energjise	Punimet sipas preventivit, zeri nr 31,32,33,	Niveli A	635,028 leke pa tvsh
<u>Kategoria NP-12</u>	Punime te inxhinierise se mjedisit	Punimet sipas preventivit ,zeri nr,23,24,29,	Niveli A	310,862 leke pa tvsh

<u>Kategoria NS-1</u>	Punime per prishjen e ndertimeve	Punimet sipas preventivit ,zeri nr,17,18,21,37,40,	Niveli A	133,820 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-4</u>	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to	Punimet sipas preventivit,zeri nr 41,45,46,47,48	Niveli A	4,014,253 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-6</u>	Sinjalistike rrugore jo ndriçuese	Punimet sipas preventivit zeri nr 16	Niveli A	91,072 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-8</u>	Ndertime p/f prej betoni te armuar struktura metalike dhe druri	Zeri nr 27,28,38,39,58,67,75	Niveli A	8,269,570 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-14</u>	Impiante te brendshme elektrike,telefonike,...	Zeri nr 35,50,51,52,53,54,55,56	Niveli A	2,561,176 leke pa tvsh
<u>Kategoria NS-18</u>	Punime topogjeodezike	-	-	-

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt te pakten:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi(profili strukturist)
- 1 (një) inxhinier elektrik
- 1 (një) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder
- 1(nje) inxhinier mjedisi

Inxhinieret e mësipërm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë në listëpagesat perkatese E-Sig për të paktën **3 (tre) muajt e fundit**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën individuale të punës,Diplomën e inxhinierëve të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162,

datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”* ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

-Është kërkuar inxhinier ndërtimi i profilit strukturist për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit, projektit, specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe

kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve që vendosen në objekt

-Eshte kerkuar inxhinier elektrik ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit, zeri nr 50,51,52,53,54,55 etj.

-Eshte kerkuar inxhinier mekanik ne perputhje me zerat e punimeve te preventivit, Zeri nr 38,39,58,60,61,64.

-Eshte kerkuar inxhinier topograf pasi ne objekt ka punime shtresash ku prania e topografit eshte e nevojshme.

-Eshte kerkuar inxhinier mjedisi eshte i nevojshem pasi kemi te bejme me punime germimi ,ndertimi ,heqje dherashetj qe kane ndikim negativ ne mjedisin perreth.Ne preventiv zeri nr 23,24,29

2.3.4 Vetdeklarimin nga **inxhinieri ndertimit, topograf, elektrik, mekanik dhe mjedisit** se ata jane te disponueshem për realizimin e kësaj kontrate.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar ne Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020 "Mbi Problematikat e konstatuara gjate monitorimit nga APP"

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt**, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai eshte i disponueshem për realizimin e kësaj kontrate ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në nenin 39, pika 6, gërma c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Eshte vendosur ky kriter duke u bazuar ne ligjin 8402 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" date 10.09.1998 i ndryshuar,pasi per cdo objekt zbatimi duhet te kete drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij ne perputhje me kete ligj dhe vendim Nr.312, datë 5.5.2010"Për miratimin e rregullores "për sigurinë në kantier"

Duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 " Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", konkretisht pika 1.2 ku citohet se: "drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit

për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili nga Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" sipas zerave të punimeve që marrin pjesë në realizim të kontratës sipas aktmarreveshjes).*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa për Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të reazlizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjesi te pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjesve të siguruar për **muajin e fundit** duhet te jetë **28(njezet e tete)**.

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjesve të siguruar për periudhen e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjesve 28(njezet e tete)

Afati 3(tre) muaj.

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte 14830:8:66=28 puntore

Nevojiten:

1-Muratori nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është 2852:8:66=5.4 puntore .Kerkojme 4 muratore dhe 1 ndihmesa

2-Pllakashtruesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3299:8:66=3.3$ punonjes

3-Mekaniku nevojitet per kryerjen e punimeve mekanike ne objekt.Sasia e oreve te punes sipas manualit është $608:8:66=1,15$ punonjes.

4-Bojaxhiu nevojitet per kryerjen e punimeve te bojatisjes.Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $323:8=0.6$ puntore

5-Punonjes rrugor nevojitet per kryerjen e punimeve te shtresave rrugore sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $1306:8=2,4$ puntore

6-Elektriciisti nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike.Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $264:8:66=0.5$ puntore

7-Saldatori nevojitet per kryerjen e punimeve te saldimit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $100:8:66=0.18$ punonjes

8-Hekurkthyesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $1446:8:66= 2,7$ punonjes

9-Specialist per konstruksione metalike nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $1081:8:66=2$ punonjes

10-Manovratore 2(dy) punonjes

11-Shofer 1(nje) punonjes

12-Puntor ndihmes te specialistave 4(kater) punonjes

Totali 28(njezet e tete) punonjes

Ne lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kerkese eshte e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes të pasqyruar në listëpagesa për të paktën **muajin e fundit**, te paisur me kontrate pune (te vlefshme), diplome leshuar nga autoritetet pergjegjese shteterore/organe/institute te akredituar, ose te *kontraktuar posacerisht per te realizuar kete kontrate ne rastin kur makinerite jane me qera* per manovratorët, ku nga këta të jenë të paktën::

- | | |
|---|--------------------|
| - Murator | 4 (kater) punonjes |
| - Pllakashtrues | 3 (tre) punonjes |
| - Mekanik | 1 (nje) punonjes |
| - Bojaxhi | 1(nje) punonjes |
| - Elektriçist | 1 (nje) punonjes |
| - Saldator | 1 (nje) punonjes |
| - Hekurkthyes | 2 (dy) punonjes |
| - Specialist për konstruksione metalike | 1 (një) punonjes |
| - Manovrator | 2(dy) punonjes |
| - Shofer | 1 (nje) punonjes |

Për stafin teknik të mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. kontratën individuale të punës të vlefshme;
- b. diplomën e shkolles/deshmi nga organe/institute të akredituar që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve të mësipërm;
- c. Manovratori duhet të jetë punonjës i specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda (Eskavatorist) dhe për këtë duhet të paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit të Transportit Rrugor.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Nevojiten:

- 1-Muratori nevojitet për kryerjen e punimeve të ndryshme të ndërtimit. Sasia e orëve të punës sipas manualit është $2852:8:66=5.4$ puntore .Kerkojme 4 muratore dhe 1 ndihmesa
- 2-Pllakashtruesi nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit.Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $3299:8:66=3.3$ punonjes
- 3-Mekaniku nevojitet për kryerjen e punimeve mekanike në objekt.Sasia e orëve të punës sipas manualit është $608:8:66=1,15$ punonjes.
- 4-Bojaxhiu nevojitet për kryerjen e punimeve të bojatisjes.Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $323:8=0.6$ puntore
- 5-Punonjes rrugor nevojitet për kryerjen e punimeve të shtresave rrugore sipas zerave të preventivit.Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $1306:8=2,4$ puntore
- 6-Elektriciisti nevojitet për kryerjen e punimeve elektrike.Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $264:8:66=0.5$ puntore
- 7-Saldatori nevojitet për kryerjen e punimeve të saldimit.Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $100:8:66=0.18$ punonjes
- 8-Hekurkthyesi nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit.Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $1446:8:66= 2,7$ punonjes
- 9-Specialist për konstruksione metalike nevojitet për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit.Sasia e orëve të punës sipas manualit është: $1081:8:66=2$ punonjes
- 10-Manovratore 2(dy) punonjes
- 11-Shofer 1(nje) punonjes
- 12-Puntor ndihmes të specialistave 4(kater) punonjes
- Totali 28(njezet e tete) punonjes

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të

kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Kërkesa për dëshmitë e manovratoreve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Kërkesa për dëshmitë e manovratoreve bazohet në Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

2.3.9 Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit:

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 7 ton (kapacitë mbajtës)	2 copë
2	Kamioncin kapaciteti deri në 3 ton	1 cope
3	Betoniere	1 copë
4	Eskavator me goma	1 copë
5	Skeleri	200 m ²
6	Autovinç deri në 5 ton	1 copë
7	Rrul	1 copë
8	Autobot uji	1 copë
9	Grejder	1 copë
10	Elektrosaldatrice	1 cope
11	Dumper kantieri	1 cope
12	Matrapik	1 cope

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).

- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Periodha e garancise per defektet eshte 2 vjet pas marrjes ne dorezim te objektit (hartimit te procesverbalit te marrjes ne dorezim dhe certifikates)

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes.

Mjet transporti vetshkarkues mbi 5 ton (ngarkesa)

Transport dhera m^3 $2115 \cdot 1.6 = 3384$ ton

Transport inerte m^3 $1295 \cdot 1.8 = 2331$ ton

Transport material te ndryshme -50 ton

Totali 5765 ton: $66 = 87.3$ ton ne dite, mesatarisht 9-10 rrugë në ditë. Kerkohen 2 mjete me nga 4-5 rruge ne dite.

2-Kamioncina nevojitet per transportimin e materialeve ne object.

3-Betoniera nevojitet per pregaditjen e llaceve dhe betoneve sipas zerave te preventivit, ne preventiv zeri nr 10,11,12,13,42,43,44,61,62.

4-Eskavatori nevojitet per realizimin e punimeve te germimit te themeleve dhe plintave dhe punime rrugore, ne preventiv zeri nr 1,6,7

5-Skelerite nevojitet per kryerjen e punimeve ne lartesi sipas zërave të preventivit, ne preventiv zeri nr 42,43.

6-Autovinci nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike sipas zërave të preventivit,ne preventiv zeri nr 50,51.

7-Rruli nevojitet per ngjeshjen e shtresave rrugore sipas projektit,ne preventiv zeri nr 5,6,7.

8-Autoboti nevojitet per lagjen me uje te shtresave te inerteve para ngjeshjes ne preventiv zeri nr 8,9.

9-Grejderi nevojitet per hapjen dhe nivelimin e shtresave te inerteve sipas projektit,ne preventiv zeri nr 8,9.

10-Elektrosaldatrice nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Ne preventiv zeri nr 27,28.

11-Dumper kantieri nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Ne preventiv zeri nr 2.

12-Matrapiku nevojitet per kryerjen e punimeve te prishjes sipas zerave te preventivit.Ne preventiv zeri nr 17,18

2.3.10 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, per objektin qe prokurohet, te cilat duhet te jene te perkthyer ne gjuhen shqipe dhe te noterizuara, sipas standardeve:

- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 e përditësuar (për sistemin e menaxhimit të cilësisë)**, e vlefshme. *Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 e përditësuar (për sistemin e menaxhimit të mjedisit)**, e vlefshme. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 e përditësuar (për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)**, ose cetifikaten ekuivalente, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*
- Certifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 3834-2:2021 e përditësuar (për sistemin e menaxhimit të cilësisë në saldime)**, ose cetifikaten ekuivalente, e vlefshme, *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020,

parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 3834-2:2021 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të cilësisë së saldimit. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me këtë ISO. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (struktura metalike me saldime) me rritjen e cilësisë së ndertimit është e nevojshme që ofertuesi të ketë pasi materialin i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze të cilat çojnë në çarjen e nyjeve.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë

tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.